



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Vahid Avdiu

Nr. Prot. 1000

Dt 08.09.2015

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, 03/2015, nenit 23 të Statutit të Përkohshëm dhe nenit 17 të Rregullores mbi punën e Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 4.9.2015, mori:

VENDIM

I

1. Prof. ass. dr. Ali Sadiku zgjidhet prorektor për Buxhet dhe Financa i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
2. I emëruari ka të gjitha kompetencat e prorektorit për Buxhet dhe Financa të këtij Universiteti të parapara me ligj.
3. I përmenduri do të ushtrojë funksionin e prorektorit për Buxhet dhe Financa të UMIB-it, në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm dhe akteve të tjera normative të Universitetit të Mitrovicës.
4. Pranimi i detyrës së prorektorit bëhet më 4.9.2015 dhe mandati i tij është i plotë (neni 4 i UA të MASHT-it 03/2015).

II

Prorektorit për Buxhet dhe Financa të UMIB-it i takon paga mujore, si dhe beneficionet e tjera, sipas Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Këshillit Drejtues;
3. Të përmendurit;
4. Fakulteteve;
5. Zyrtarit ligjor;
6. Shërbimit financiar;
7. Zyrës së personelit.



Kryesues i Këshillit Drejtues

Dr. sc. Vahid Avdiu